



KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Nr 6101/1 Prot.

Vau Dejes me 31. 10.2022

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (e) dhe në rregulloren e brendshme për funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e fshatit Kosmaç (të pajisur me dokument identifikimi), Njesia Administrative Bushat të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin e meposhtëm:

“Për miratimin e dhënies me qera të sipërfaqes prej 190m2 pjesë e pasurisë nr.209/2, Zk nr 2236, e llojit “ Pa fryt”, ndodhur në fshatin Kosmaç/58, Bashkia Vau Dejes”

Paraqitur nga:

(Drejtoria e Prokurimeve dhe Integritetit Sektori Aseteve)

Dëgjesa publike do të bëhet me datë **25.11.2022 ora 11.00** fshati Kosmaç, Njesia Administrative Bushat.

Gjithashtu ju ftojme të bëheni pjesë e dëgjësës për projekt vendimin e mësipërm, nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

(info@vaudejes.gov.al , ardian.celepija@vaudejes.gov.al , facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës).

SEKRETARI KËSHILLIT

Ardian CELEPIJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETIVE

PROJEKT VENDIM

Nr 09. Datë 31.10.2022

Për dhënien me qira të sipërfaqes prej 190 m², me afat deri në 1 vit, pjesë e pasurisë nr 209/2, Zk nr 2236, e llojit “Pa fryt”, për qëllime biznesi në fushën e shërbimeve, tregtisë etj, në fshatin Kosmaç, Nj.Ad Bushat, Bashkia Vau Dejës.

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar. Në VKM nr. 246 dt 31.03.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 68, datë 28.01.2008, të këshillit të ministrave, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, kapitulli I, pika 2, pika 5 shkronja “a”, pika 6 shkronja “a”, të VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, si dhe në Udhëzimin nr 13, datë 26.04.2018, për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, propozojmë që në mbledhjen e radhës, Këshilli Bashkiak Vau Dejës të:

VENDOSI :

1. Dhënien me qira të sipërfaqes prej 190 m², pjesë e pasurisë nr 209/2, Zk nr 2236, e llojit Pa fryt, ndodhur në fshatin Kosmaç, Nj.Ad Bushat, Bashkia Vau Dejës.
2. Në këtë pasuri mund të ushtrohet aktivitet ekonomik, në fushën e shërbimeve, tregtisë, industrise, etj.
3. Efektet: Jep impakt pozitiv në komunitet duke hapur vende të reja pune, si dhe sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen më pas në investime publike.
4. Tarifa e qirasë vjetore të jetë 19 000 leke/vit, bazuar në Udhëzimin nr 13, datë 26.04.2018, për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

KRYETARI
Mark BABANI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
Kristian SHKRELI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETEVE

RELACION


DHËNIE NË PËRDORIM TË PASURISË SHTETËRORE E LLOJIT "PA FRYT" ME
SIPËRFAQE PREJ 190 M2, NË FSHATIN KOSMAÇ, PRONË E BASHKISË VAU DEJËS

Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Të nderuar këshilltarë,
Bashkia Vau Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të tjera ka edhe administrimin dhe shfrytëzimin e resurseve të saj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, posaçërisht të kaluara në pronësi të saj, me qëllim dhënien në përdorim të tretëve, me objektiv për të siguruar të ardhura për bashkinë, që më pas kthehen në investime publike, si dhe duke hapur vende të reja pune me impakt zbutjen e varfërisë dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së jetës në komunitet.
Mirëadministrimi i Aseteve publike, është një pjesë e rëndësishme e qeverisjes lokale të mire.
Me transferimin e pronave të paluajtshme publike shtetërore në administrimin vendor menaxhimi i aseteve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin e Bashkisë.
Bazuar në ligjin nr 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjin nr 8744 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit, në njesitë e qeverisjes vendore", ndryshuar, Bashkia jep në përdorim subjekteve të interesuar, pasuritë e paluajtshme në pronësi të saj, me kontratë qiraje. Bazuar në VKM-së nr 54 datë 05.02.2014, Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, sipërfaqet nën 200 m2, jepet me qira me afat deri në 1 vit dhe pa konkurim.
Vlera dysheme e qirasë vjetore, llogaritet sipas Udhëzimit nr 13, datë 26.04.2018, për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, Në rastin konkret kemi 190 m2 që propozohet të jepen me qira, me tarifën prej 19 000 lekë në vit. Pas miratimit në Këshillin Bashkiak, dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut, vazhdon procedura me lidhjen e kontratës së qirasë.
Për sa më sipër, ju ftojme për të miratuar këtë Projekt Vendim.

KRYETARI
Mark BABANI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
Kristian SHKRELLI



Hartuesit e relacionit: Ndoc Baqli

Ilda Prendi



VKM 68



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 68 , datë 28.1.2008

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN,
NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS BUSHAT, TË
QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Bushat, të qarkut të Shkodrës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.


1000
1043
BRESHA

Lista përbëhet nga:

- lista e ish-komunës Bushat, me 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) fletë, përfundon me numrin rendor 516 (pesëqind e gjashtëmbëdhjetë);
 - lista e ish-komunës Barbullush, me 24 (njëzet e katër) fletë, përfundon me numrin rendor 122 (njëqind e njëzet e dy).
2. Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Bushat për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM



BUIJAR NISHANI

Komuna Bushat

VKM 68 dt 28-01-2008 Lidhje 1

N° irat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-180; 190;192;193;200 275-334.(komuna Bushat)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
181-188;248-250 (komuna Bushat) 7-9 (ish kom.Barbullush) 251-261 (kom. Bushat)	Varrezat publike	Në pronësi
1-3; (ishkom.Barbullush) 268-271 (komuna Bushat) 4; (ish kom. Barbullush)	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
262-267 (komuna Bushat) 5;(ish komuna Barbullush)	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
423;424;425;426; 427;428;429;430(komuna Bushat)	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive.	Në pronësi
118;119; (ish komuna Barbullush)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
204;431- 434;447;448;435;457;459; 462;464;474;476;482;485; 490;492;495;497;498;499; 500.(komuna Bushat)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi
114;(ish komuna Barbullush) 335-345(komuna Bushat)	Pyje Kullota	Në pronësi
57-64;(ish komuna Barbullush) 386-396(komuna Bushat)	Ujesjelles Kanalizime	Në pronësi
69-78;(ish komuna Barbullush) 214-243;247.(komuna bushat)	Prona që përdoren strehim.	Në pronësi
189,191,194-199, 201;202,203;205-213;244- 246;360-378;412-422.(komuna Bushat). 10-56,79-91,120,121,122, (ish komuna Barbullush)	Infrastruktura (rrugë vendore, lulishte sheshe) dhe shërbime publike.	Në pronësi

MINISTRI
Bujar NISHANI

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
165	3506	395/1	Truall	Troje te ish magazinare te sektorit F.Stojke Komuna Bushat	2312		Pa Funksion	Komuna Bushat	Komuna Bushat	Zene forcerisht
166	3506	441/4	Truall Ndertese	Furre buke F.Stojke Komuna Bushat	2300	400	Pa Funksion	Komuna Bushat	Komuna Bushat	Nuk Funksionon
167	2336	63/2	Truall Ndertese	Ish riparim sherbimet Fshati Kozmac Komuna Bushat	540	90	Pa Funksion	Komuna Bushat	Komuna Bushat	Zene forcerisht
168	2336	63/4	Truall	Hapesire publike Qender F.Kosmac Komuna Bushat	2370		Pa Funksion	Komuna Bushat	Komuna Bushat	Zene forcerisht
169	2336	209/2	Truall	Ish mulliri F. Kosmac Komuna Bushat	1700		Pa Funksion	Komuna Bushat	Komuna Bushat	Zene forcerisht
170	2336	168	Truall	Truall I ish magazines Fshati Kozmac Komuna Bushat	8920		Pa Funksion	Komuna Bushat	Komuna Bushat	Zene forcerisht
171	2644	4	Truall	Hapesire midis ish stiallave derrave F.Meigushe Komuna Bushat	1000		Pa Funksion	Komuna Bushat	Komuna Bushat	Zene forcerisht
172	2644	25	Truall	Ish stiallat e derrave F.Meigushe Komuna Bushat	16200		Pa Funksion	Komuna Bushat	Komuna Bushat	Zene forcerisht

KARTELA E PASURISE SE PATUAJTSHME

Vol. 2 fq. 11

A - SEKSIONI IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kallastele 1236 NR. I PASURISE 109/1

Indeksi i Kartelave 1-34-11 (1-8)

Adresa e pasurise: Breshi JAKOBI Q/1 KOSOVA

Rr. PG Sh K Ap

PERLINDIMTARI (Data) 28/12/1981

Pershkrimi i Veprimit

B - SEKSIONI PERSHKRIMIT TE PASURISE

Tipi i Pasurise: Tull Brenda V.K. Nr. Ju -> Pr. Ref.

Nr. Total e Pasurise	Nr. Sip. Totale sa Urdani	Nr. Sip. Totali sa Ndertese
1	1	1
Ref	Ref	Ref
2 1700	2	2
Ref 18 JUNE 1996	Ref 18 JUNE 1996	Ref 18 JUNE 1996
3	3	3
Ref	Ref	Ref
4	4	4
Ref	Ref	Ref

Evat e shtesave per shprehje

TULLAST

Kantieri i Pasurise Nr. Ju

Nr. i Pasurise (Pallate)

Val. Fu

SEKSIONI I PRONESISE

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Emri i Atesia Miretim	Nr. Pasap	UEJB	Adresa e Primit	Shtesa e Pagimit	Data e Lashit Certificate	Shtetes	Funksion
	6.11.1981	JAKOBI			JAKOBI - KOSOVA				

No. Dik	Data e Regjistrimit	Tipi			

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj.

No. Dik	Data e Regjistrimit	Tipi	Pershkrimi	Data e Lesh te Certifikates	S

PLAN RILEVIM

PERGATITI

HAMID ÇULIQ

Liçensa Nr. T.0675/2 Dt. 10.04.2018

Data e pergatitjes. 28.10.2022

SIPERFAQE

S1= 190 m²

Vula / Firma

**ING. TOPOGRA,
HAMID ÇULIQ
NR. LIÇENSA T-0675/2**

A.IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 2236

NR.PASURISE 209/2-S1 VOL 5 FQ 77

SHKALLA 1:2500

INDEKSI I HARTES K-34-76-(2-B)

ADRESA E PASURISE: Rrethi SHKODER KOSMAC

QIRAMARRES : DRILON SALIHI

